REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1108, 1112/20
Datë/Datum. 29.12.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*
Dior Halili	***21/12/2020***	***29/12/2020***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 18.12.2020, **OE "N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED"**, ka parashtruar ankesë me nr: **1112/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore"** me nr. të prokurimit: **616-20-1154-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtinë.**

Me datën: 17.12.2020, **OE "BOTEK SHPK"**, ka parashtruar ankesë me nr: **1108/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore"** me nr. të prokurimit: **616-20-1154-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtinë.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurën: procedurë e hapur, lloji i kontratës: furnizim, ndarja në pjesë: jo, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim.
B05 Njoftimi për kontrate: 03.04.2020
Afati i fundit për dorëzim te tenderit: 02.06.2020 ora 13:30
Kriteri për dhënien e kontratës : Çmimi më i ulët.
Përgjigjja e AK për sqarimet e Dosjes se Tenderit e publikuar ne platformën e E-prokurimit : 13.04.2020
Kërkese për qasje ne dokumente: 28.08.2020
Kërkesa për Rishqyrtim dërguar AK përmes Platformës se e-Prokurimit: 02.09.2020

Vendim i Autoritetit Kontraktues mbi Refuzimin e Kërkesës për Ri-Shqyrtim: 08.09.2020
Vendimi i OSHP-së nr. 661-683/20: 15.10.2020
Vendimi i AK-së për dhënie të kontratës: 03.12.2020
Kërkesa për rishqyrtim: 04.12.2020
Kërkesa për rishqyrtim: 08.12.2020
Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues 09.12.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

Si sqarim, për faktin që ky raport përfshin pretendimet ankimore të 2 operatorëve ekonomik ankues të të njëjtit aktivitet të prokurimit, pretendimet ankimore do të listohen me radhë duke filluar nga ato të OE ankues **"N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED"**, pastaj **"BOTEK SHPK"**. Konstatimi i fakteve (pjesa 3) dhe përgjigjet ndaj pretendimeve (pjesa 7) përmban të njëjtën renditje.

Me datën: 18.12.2020, **OE "N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED",** ka parashtruar ankesë me nr: **1112/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore"** me nr. të prokurimit: **616-20-1154-1-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtinë.**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:
Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka vepruar në përputhje me LPP-në, konkretisht:
Nenin 1 - Qëllimi
Nenin 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 28 – Specifikimet teknike
Nenin 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 72 - Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
Neni 99 – Funksionet dhe Kompetencat e OSHP-së
Neni 105 – Kompetencat e OSHP-së

Si dhe nuk ka vepruar në përputhje me RRUOPP-në konkretisht:
Neni 41.3
Neni 49.25
Neni 49.26

Autoriteti Kontraktues (AK) ne kundërshtim me nenin 1,7, 28, 49, 72, 99 dhe 105 ka vepruar kundërligjshëm duke shpallur njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin shpall fitues GOE"ARITECH Sh.P.K; CIMI @ ELECTRONIC Sh.P.K dhe na eliminon ne me arsyetimin se nuk kemi dorëzuar katalogun e njëjte me të cilin kemi ofertuar në dosjen e tenderit. Me këtë veprim AK ka vepruar në kundërshtim me vendimin e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) duke e injoruar atë pasi që në vendimin dhe arsyetimin e tyre pas evoluimit të dëshmive kanë vlerësuar se dokumenti (katalogu) i deponuar në dosjen e tenderit ka qenë i rregullt dhe valid dhe na kanë dhënë të drejtë neve si OE me çka lënda është kthyer në ri-vlerësim dhe rivendosje. Vlerësojmë se kjo çështje është trajtuar në Organin Shqyrtues të Prokurimit dhe nga Eksperti

Shqyrtues dhe mund të konsiderohet si çështje e gjykuar "res judicata" dhe si e tillë e përfunduar dhe duhet të konsiderohet e pranueshme nga AK.

PROVË: Vendimi i OSHP-së i datës 15.10.2020 nr.661-683/20 Edhe përkundër kësaj, OE N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED", ka ofruar sqarime duke i konfirmuar me letër zyrtare nga prodhuesi se produkti i përmendur është origjinal, me të njëjtin kod identifikues (A315-54K-361G) dhe i ofertuar nga përfaqësuesit e autorizuar. Specifikacionet teknike të perënduara në letrën sqaruese kanë synuar të sqarojnë procesin e modifikimit të produktit dhe asesi të ndryshojnë përmbajtjen bazë nga katalogu ofertues.

AK gjithashtu ka vepruar kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 të LPPsë dhe nenin 49.25 dhe 49.26 ku AK ka dështuar të verifikoj kushtet formale të dokumenteve të tenderit pasi që ka pranuar dokumentin me nr. Referencë 1038ERQ ISO 9001:2015, Quality Management System në emër të CIMI @ ELECTRONIC Sh.P.K si jo të rregullt dhe sipas verifikimit dhe vlerësimit tonë janë të falsifikuara. Ketë fakt e bazojmë se pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë shihet qartazi se në të njëjtin ka ndërhyrje teknike, gabime të mëdha drejtshkrimore nga gjuha e huaj-angleze si dhe nënshkrimi i "personit autorizues" është i njejti sikur edhe në dokumentin e paraqitur fillimisht si certifikatë e ISO Standardit por nga një firmë krejtësisht e ndryshme. Pra, si është e mundshme që i njëjti person autorizues-certifikues të jetë në dy firma krejtësisht të ndryshme?! Këto fakte i kemi trajtuar edhe ne shkallen e parë të ankimimit prej ku kemi kërkuar nga Autoriteti Kontraktues që të trajtoj pretendimin tonë se pala fituese sipas njoftimit për vendim ka bërë shkelje të rëndë (duke prezantuar një dokument të rrejshëm) dhe Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të veproj në përputhje me nenin 99 paragrafi 2 i LPP-së.

PROVË: Certifikatat e ISO Standardit me nr.: 1038ERQ dhe ER-236-QMS

AK jo vetëm që nuk ka vepruar siq është e obliguar sipas dispozitave ligjore por pretendimet tona të bazuara dhe të faktuara i ka hedhur poshtë si tërësisht të pabazuara dhe ka konfirmuar njoftimin mbi vendim dhe na ka shpallur si të papërgjegjshëm pa asnjë bazë.

Përveç kësaj, edhe po qe se si i tillë dokumenti të ishte i rregullt, i njëjti është deponuar si dokument i ri dhe nga një firmë tjetër prej asaj që ka deponuar në momentin e ofertimit me çka ka vepruar në kundërshtim me nenin 41.3 të RRUOPP i cili përcakton se: "Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim"/

Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës: është i paqartë dhe i gabueshëm për faktin se ka përzier subjektet e këtij procesi duke emërtuar gabimisht OE (shih vendimin e AK) me çka ka shkaktuar paqartësi juridike dhe ka krijuar huti në definimin e vendimit përfundimtar. I njëjti nuk përmban as numër protokolli për referencë.

Duke u bazuar ne ato qe u ceken me lartë, bazën ligjore, faktet materiale lidhur me këtë procedure tenderuese, kërkojmë qe te rishqyrtohet dhe pranohet kërkesa jone për anulim të vendimit të autoritetit kontraktues dhe çështja të rivendoset në favorin tonë.

Me datën: 17.12.2020, **OE "BOTEK SHPK"**, ka parashtruar ankesë me nr: **1108/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet**

arsimore" me nr. të prokurimit: **616-20-1154-1-1-1,** iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtinë.**

OE ankues ka pretenduar që janë shkelur këto dispozita ligjore:

Shkeljet e dispozitave te Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092:

- Neni 59: Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

- Neni 28: Specifikimet teknike.

- Shkeljet e dispozitave - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik- A01 Neni 20 - Specifikimi Teknik.

Pas pranimit të Vendimit mbi Kërkesën për Rishqyrtim me datë: 08.12.2020, ku AK pas Rishqyrtimit të kësaj procedure të Prokurimit ka vendosur sërish ta shpërblej me Kontratë të njëjtin grup OE.
Ne kemi Argumentuar edhe njëherë qartësisht se AK NUK ka zbatuar plotësisht Vendimin e OSHP për Rivlerësim dhe se sërish ka bërë shkelje të LPP **Neni 55 i LPP-së nr 04 L 042, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve si** dhe RRUOPP (sipas Nenit 28 te LPP) .
Në vijim po i zbërthejmë vetëm në pika të shkurtra Pikat e Ankesës sonë të cilat mbështet si në Procedurën e parë të Ankimimit në 3 pika kryesore.
Pretendimi 1. AK ka bëre shkelje të LPP dhe UOPP duke shpërblyer me kontratë një grup të OE të papërgjegjshëm teknikisht, pasi që ashtu sikurse e kemi argumentuar me PROVA përtej çdo dyshimi, ky Grup i OE ka Ofertuar Pajisjen HP.....e cili NUK përmbushë kërkesën Minimale të vendosur ne ANEKSIN 1 të DT.

- AK përmes sqarimeve të tenderit (dt. 09.11.2020) po tenton të arsyetoj ofertën e këtij grupi të OE e i cili në fakt ka një shpjegim dhe arsyetim të paqëndrueshëm / pabazuar.
  Ky OE po pretendon që ta Modifikoj (pa lejen e prodhuesit) produktin jashtë mundësive, kapacitetit dhe specifikacioneve teknike të produktit PC ***HP Desktop Pro G3*** të ofertuar në tender. Një gjë të tillë NUK e mundëson Prodhuesi dhe se kjo del jashtë specifikimeve teknike të produktit nga prodhuesi të dhënë në Broshurën e prodhuesit dhe rrjedhimisht del jashtë standardit të prodhuesit i cili sikurse të gjithë prodhuesit tjerë i certifikojnë dhe testojnë pajisjet e tyre para daljes ne prodhim ne të gjithë parametrat teknik dhe përformance së tyre si dhe përpilojnë Broshurën mbi Pajisjen.

Pra, për Pozicionin 2. në dosjen e tenderit është kërkuar KOMPJUTER Brand Name - Mid Tower që ky kompjuterë të ketë; 1X SSD - 500GB, 1X HDD-500 GB dhe 1x Lexuesi optik - DVD Drive. Për këtë pozicion ky grup i *OE "ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk"* kanë dorëzuar Broshurën nga Prodhuesi HP për ***Kompjuter HP Desktop Pro G3,*** ku shihet çart në broshure (faqen2) që ky Modeli i PC, i konfirmuar nga vetë prodhuesi HP, nuk mundet me ofruar konfigurimin e kombinuar për Drives; 1X SSD 500 GB plus 1X HDD 500 GB si dhe 1 x Lexuesi optik DVD Drive, siç është kërkuar ne dosjen e tenderit.

PROVA 1: Për ta vërtetuar këtë fakt, ju lutem e gjeni te bashkangjitur broshurën produktit të HP ***Desktop Pro G3*** e dorëzuar nga vete grupi i OE, Prova;***"Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor"*** konkretisht në faqen 2 të kësaj broshure ku shkruan qartësisht "Note apo KUJDES /" se ky model i PC suporton vetëm këto lloje të konfigurimit si ne vijim:

Note: Following configurations are supported:
a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive
b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive
c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage
d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage

Pra, duke u bazuar në këtë konfigurim si më lartë nga prodhuesi qartësohet përtej çfarëdo dyshimi, se ky Model i PC (Pro G3) NUK mundëson konfigurimin 2 X Storage Drive dhe 1 X Optical Drive.
Pra, edhe pse këto Fakte/ Prova janë plotësisht ta bazuara në dokumentet e tenderit të dorëzuara nga vetë OE dhe mund të Ri-konfirmohen kurdo dhe nga cilido në Web-Site e Prodhuesit të HP, ne e ftojmë Ekspertin e lëndës që të kërkoj një Konfirmim shtesë dhe direkt nga Prodhuesi për ti Ri- konfirmuar këto fakte dhe pretendimin tonë.

Pretendimi 2. Në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë te datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK- se, OE duhet te ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë këto specifika teknike:

Përgjigjja për OE:
Mbajtësi duhet:
- Të jetë statik/i palëvizshëm dhe i përshtatshëm për vendosjen horizontale te TV-së ne muret e klasave.
- Të jetë nga materiali i forte dhe rezistent ne rastet kur ndoshta mund te tërhiqet me force nga nxënësit.
- Të përkrah peshën e TVsë te specifikuar ne katalogun e prodhuesit.
- Të ketë hapësirën e nevojshme për shfrytëzimin e porteve dhe funksioneve tjera mbrapa TV-se te kërkuara ne specifika.
- Të ngjitet me bulona te forte dhe mire ne mur, me c'rast TV do të sigurohet nga dëmtimi i mundshëm fizik si pasoje e shkaqeve te lartcekura.

Për këtë pozicion, *OE "ARITECH shpk & Cimi Electronic shpk"*, në ofertën e tyre NUK ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV si dhe **NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV, në mënyrë që AK të ketë mundësi ta vërtetoj që mbajtësi për TV i përmbush te gjitha specifikat e kërkuara ne Ankesin I të DT dhe ashtu sikurse ishte kërkuar qartë me sqarime shtesë nga AK.**
Prandaj ka qenë sipas LPP dhe është obligative sipas kërkesës AK në dosjen e tenderit që OE të dorëzojnë specifikimet e te detajuara teknike te pajisjeve te ofertuara.

- **Rrjedhimisht, ky grup i OE ka dështuar të përmbushë kriterin themelorë të DT (dhe sqarimeve shtesë) si dhe**
- RRUOPP, (sipas Nenit 28 të LPP-së), i cili qartëson, citat; ***"Në rast se mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara & katalogu AK refuzon tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm"*** (**Prova 1.** ***"Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik"***, faqe 88"). Pra, sipas këtij UOPP, ..." specifikimit teknik" *AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale te një produkti, ndërsa OE duhet te dorëzoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund te dorëzoj specifikimin teknik te një produkti te caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do te jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar). (faqe 82 i UOPP).*

Përpjekjet e dështuara të AK që përmes sqarimeve të tenderit ta arsyetojnë mungesën e Specifikimit Teknik si dhe Emrit /Brandin e produktit të ofertuar, nga ky grupi i OE, janë plotësisht në kundërshtim me LPP dhe UOPP (Neni28) dhe për më tepër kjo përbën ndryshim të Ofertës Teknike (pra ndryshim të materialit) gjë që NUK e lejon LPP.

Duke marrë për bazë këto Fakte të paraqitura edhe ne Ankesën e parë ne OSHP (PSH 661- 683/20) për këtë lëndë mbi të cilat Prova ky tender ishte kthyer me Vendim të OSHP në Rivlerësim e ftojmë:

1. Ekspertin Teknik të ti verifikoj Provat që lidhen direkt me deklarimin e prodhuesit HP ne Broshurën Zyrtare të HP në lidhje me Pretendimin 1: Kapaciteti dhe mundësia e Konfigurimit të ***Kompjuter HP Desktop Pro G3,*** *apo ti kontaktoj direkt Prodhuesin HP për ta marrë këtë konfirmim zyrtarisht dhe për Rikonfirmua pretendimet tona.*
2. *Panelin Shqyrtues të OSHP që duke u mbështet ne Vendimin e tyre* (PSH 661- 683/20) dhe Provat të prezantuara në ankesën e parë dhe Ri-konfirmuara ne ketë ankesë, të marrë një vendim meritorë dhe bëjë aprovimin e Ankesës sonë si të bazuara si dhe Lëndën ta kthej ne Rivlerësim, duke udhëzuar /detyruar AK ti zbatoj Vendimet e OSHP dhe në veçanti ta respektoj në tërësi Nenin 59 të LPP si dhe UOPP Piken 28.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Fakt 1: *Kërkesa numër 4 në FDT tek "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale", ku thuhet që Operatorët Ekonomik duhet të sjellin katalogun për* ***produktet tekonologjike.***

		2. Operatorët Ekonomik duhet te kenë Autorizimin nga Prodhuesi	**2. Autorizimi nga Prodhuesi (origjinal) i vulosur dhe i nënshkruar - DAP ose MAP**
		3. Operatorët Ekonomik duhet të kenë Certifikatën ISO Standardeve 9001-2015 me validitet për vitin 2020-2021	**Certifikata ISO Standard 9001-2015 me validitet 2020-2021.**
		4. Operatorët Ekonomik duhet të sjellin katalogun për produktet tekonologjike	**4. Katalogu i nënshkruar dhe i vulosur**

Fakt 2: *Email e dërguar nga EAS International, si trupë e certifikimit për ISO standardin e kërkuar nga AK, ku konfirmon për kompaninë e njërit prej OE të rekomanduar për kontratë që me kërkesën e këtyre të fundit, EAS International do të përfundojë auditimin e nevojshëm si parakush për zgjatjen e validitetit të ISO Certifikatës.*

---------- Forwarded message ---------
From: **EAS ICC** <eas.icc@gmail.com>
Date: Tue, Jun 2, 2020 at 11:01 AM
Subject: Re: Urgent request
To: cimiELECTRONIC shpk <cimielectronicshpk@gmail.com>, <info@easicc.com>

Dear All,

Based on your request, we as a certification body inform you that according to the rules of the International Organization for Standardization (ISO), your certificate with number ER-236-QMS is valid until 01.07.2020.
The maintenance of the certificate is done at the request of the client and before the expiration date.
We as the certification body inform you that we will perform the audit according to your request so that your certificate is valid until 2021.

Thank you for your request.

Kind Regards,
Lejla.
Quality Manager for EAS International

On Mon, Jun 1, 2020, 23:11 cimiELECTRONIC shpk <cimielectronicshpk@gmail.com> wrote:
Dear All
Our esteemed company is the customer and please request more than ISO 9001: 2015, with number 57874, valid until 01.07.2020,
We would like to participate in an activity, but the request has been valid until the end of the 2020 Visit.
We request that you confirm that you support us in the validity of this certificate (Audit).
Please provide us with a confirmation letter that you will verify our validity and certify what we express interest in and confirm the validity from 01.0.07.2020- 01.07.2021. The request is urgent in search for dt.02.06.2020 at 11:00
Please have our understanding

Fakt 3: *Konfirmimi i ACER sa i përket MAF-së së dërguar nga OE ankues Aritech në lidhje me Product Number të llaptopit për të cilin edhe është ofertuar.*

albanbikliqi@artech-ks.com

From: Mislav.Jagunic@acer.com
Sent: Friday, July 17, 2020 2:27 PM
To: flamur.sallahu@rks-gov.net
Cc: albanbikliqi@artech-ks.com
Subject: Confirmation of MAF - company Artech N.T.SH.
Attachments: MAF Artech Municipality.pdf

Dear Sir,

this is to confirm that attached MAF issued to company Artech N.T.SH. from ACER Sales International SA, to participating on the public tender for Municipality of Prishtina – Republic of Kosova is valid.

Best regards,

Mislav Jagunić
Head of Representative Office | Adriatic Region
Acer Representation in Croatia
Email: mislav.jagunic@acer.com | Phone: +385 1 5005 070 | Mobile: + 385 91 3899 099

Follow us: facebook/AcerHrvatska | facebook/AcerSrbija | facebook/AcerSlovenija | facebook/AcerMacedonia

acer

This email contains information that is for the sole use of the intended recipient and may be confidential or privileged. If you are not the intended recipient, note that any disclosure, copying, distribution, or use of this email, or the contents of this email is prohibited. If you have received this email in error, please notify the sender of the error and delete the message. Thank you.

acer

ACER SALES INTERNATIONAL S.A.
Via della Posta 28
6934 Bioggio, Switzerland

Tel. +41 91 261 01 11
Fax +41 91 261 03 22

01.09.2020

To:
Municipality of Prishtina
Republic of Kosova

Confirmation Letter

WHEREAS ACER Sales International SA, Via Della Posta 28, 6934 Bioggio, Switzerland, do hereby confirm that not all Acer PN's (Part Numbers) indicating exact Acer models & configurations are listed on official Acer web pages.

Official Acer web pages contains general information about Acer products, series and features, along with only few PN's & configurations.

Yours faithfully,

ACER SALES INTERNATIONAL SA
Via della Posta, 28
6934 Bioggio, Switzerland

Tai Chi Shih
Director
Acer Sales International S.A.

Model: Acer Aspire 3 A315-54K offered with specifications: A315-54K-361G is an original product from ACER and that the created brochure contains all specifications as required in the tender dossier.

Acer does not post the entire part number on the Website, only the model like Aspire 3.

Code -361G it is specific project sepcification that descipte of all specification listed below.

Model A315-54K

Desc: A315-54K-361G ESHELL_1SPAAL1 UMACkk_4U 3813/1 * 4G / 500G / 36Wh / FHDPLB_acB_0.3MM_Sha Black_A111 -

- I3-8130U
- 4 GB
- 500 GB
- FHD
- No OS
- 3 years guarantees

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga **N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED" dhe OE "Botek SHPK" Prishtinë**, ankesë me nr: **1108_1112/20**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: : **"Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore"** me nr. të prokurimit: **616-20-1154-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KK Prishtinë**

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
N/A

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
661-683/20
15.10.20
PRISHTINË / PRIŠTINA

PSH.nr.661/20
683/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje: Z. Goran Milenković - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi - Referues dhe Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesave të parashtruara nga grupi i operatorëve ekonomik "Botek" SHPK - Prishtinë dhe OE "Artech NTSH & Eramed NTP" - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik Aritech sh.p.k, Cimi@Elektronic sh.p.k - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore" me nr. të prokurimit 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë më datën: 14.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHEN**, pjesërisht si të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Botek" SHPK –Prishtinë dhe OE "Artech NTSH & Eramed NTP"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore" me nr. të prokurimit 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë.

II. **ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore" me nr. të prokurimit: 616-20-1154-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues KK Prishtinë, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konfirmon dispozitat ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të OE ankues **"Artech NTSH & Eramed NTP"** ku thuhet që AK ka vepruar kundërligjshëm duke shpallur njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin shpall fitues GOE"ARITECH Sh.P.K; CIMI ELECTRONIC Sh.P.K dhe i ka eliminuar OE ankues **"Artech NTSH & Eramed NTP"** me arsyetimin se nuk kanë dorëzuar katalogun e njëjte me të cilin kanë ofertuar në dosjen e tenderit, Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si cështje e gjykuar "res judicata". Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 683/20.

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues **"Artech NTSH & Eramed NTP"** ku thuhet që AK gjithashtu ka vepruar kundërligjshëm në kundërshtim me nenin 72 paragrafi 3 të LPPsë dhe nenin 49.25 dhe 49.26, pasi që ky i fundit dështuar të verifikoj kushtet formale të dokumenteve të tenderit pasi që ka pranuar dokumentin me nr. Referencë 1038ERQ ISO 9001:2015, Quality Management System në emër të CIMI ELECTRONIC Sh.P.K si jo të rregullt dhe sipas verifikimit dhe vlerësimit tonë janë të falsifikuara, Eksperti pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit dhe shkresave të dërguara nga palët e përfshira, gjen pretendimin si të pabazuar duke argumentuar si në vijim:

- Në letrën standarde për sqarim të dosjes së tenderit dërguar OE të rekomanduar nga Autoriteti Kontraktues, OE i rekomanduar ka bashkëngjitur certifikatën e lartpërmendur duke vërtetuar kështu validitetin e një certifikate të tillë deri me 01.07.2021. Falsifikimi i një dokumenti të tillë mbi bazën e ndërhyrjeve teknike dhe nënshkrimit të personit të autorizuar nuk mund të evidentohet nga Eksperti Shqyrtues dhe nuk është nën përgjegjësinë juridike dhe as teknike që një vërtetim i tillë të konstatohet nga ky i fundit. Certifikata e bashkëngjitur (shih më poshtë) është konform fushëveprimit të kërkuar dhe si e tillë është valide në afat kohor të përcaktuar.

Zertifikat

Certificate

Quality Management System

Certificate No: 103MERQ

For: Cimi @ ELECTRONIC SH.P.K

Address: Rr. Azem Bejta, Skënderaj, Prishtinë

Assessment Scope: Supply, installation of security system equipment, camera, electrical systems, automatic systems.

International Standard: ISO 9001:2015, Quality Management System

Issue: 01, Certification date: 02 July 2020
Date of issue of the certificate: 02.07.2020
Date of validity of the certificate: 01.07.2021

Assessment Project: This assessment project for certificate is realized by EBSGMBH based on project/contract: 02.06.2020.
Validity remains subject to satisfactory annual surveillance audit.
The certificate will be extended for one year.
Recertification audit before date of first issuance

Certificate search: Online: www.ebsgmbh.com/QMTUV/103MQ
Offices: EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
Email: validity@ebsgmbh.com

Excellent Bewertungssystem

QMS ISO 9001:2015

Authorized Signature

International Communication and Information Office:
EBS # Qualitätsmanagement Technische Inspektion
Und Validierung
Kettenhofweg 1, D-60325 Frankfurt am Main, Germany
www.ebsgmbh.com

*Document model in English language, Page: 1-1

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues **"BOTEK SHPK"** ku thuhet që AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe UOPP-së pasi ka shpërblyer me kontratë një grup të OE të papërgjegjshëm teknikisht pasi që këta të fundit kanë ofertuar me pajisjen HP e cila nuk përmbushë kërkesën minimale të vendosur në Aneksin 1 të DT-së, gjegjësisht konfigurimin e kombinuar për Drives; SSD: 500 GB dhe HDD: 500 GB si dhe Lexuesi optik: DVD Drive pasi që në broshurën e dorëzuar nga vete OE i rekomanduar "Broshurat - Pjesa 2 - PC dhe Monitor" konkretisht ne faqen 2 të broshurës shkruan qartësisht "KUJDES" si ne vijim: *Note: Folloëing configurations are supported: a) 3.5" internal storage & 9.5mm optical drive, b) 2.5" internal storage & 9.5mm optical drive, c) 3.5" internal storage & 2.5" internal storage d) 2.5" internal storage & 2.5" internal storage.* Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si cështje e gjykuar "res judicata". Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 661/20.

Sa i përket pretendimin ankimor të OE ankues **"BOTEK SHPK"** ku thuhet që në dosjen e tenderit gjatë procedurës së sqarimeve shtesë te datës 13.04.2020, është qartësuar nga ana e AK- së se operatorët ekonomikë duhet te ofertojnë edhe mbajtës të TV i cili duhet t'i ketë specifikat teknike si tek pjesa e "Pretendimeve Ankimore" e këtij raporti, ku OE ankues thotë që për këtë pozicion, OE ARITECH shpk & Cimi "Electronic shpk, në ofertën e tyre NUK ka dorëzuar fare Broshurën për mbajtësin e TV si dhe NUK ka specifikuar fare modelin dhe specifikat e mbajtësit të TV, Eksperti Shqyrtues vecse ka trajtuar pretendimin në

fjalë, andaj konform nenit 105 të LPP-së, respektivisht paragrafit 2.16 një pretendim i tillë duhet trajtuar si çështje e gjykuar "res judicata". Konstatimi mbi pretendimin e lartpërmendur është dhënë në raportin me numër rendor 661/20.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues i sheh ankesat e operatorëve ekonomik ankues si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje teknologjike për institucionet arsimore" me nr. të prokurimit: "616-20-1154-1-1-1", aktivitet ky i iniciuar nga AK: KK Prishtinë, të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues duhet të jenë: pjesërisht të bazuara dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues **KK Prishtinë**
- Panelit Shqyrtues **OSHP**
- OE ankues **OE "Botek SHPK" – Prishtinë**
  N.T.SH. ARTECH" dhe "N.T.P ERAMED